


Tregtia e jashtme e mallrave

Prill 2017

Tiranë, më 17 Maj 2017: Në Prill 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 24 mld lekë, duke u rritur me 13,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 1,6 %, në krahasim me Mars 2017. Importet e mallrave në Prill 2017 arritën vlerën 50 mld lekë, duke u ulur me 4,3 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 7,7 %, në krahasim me Mars 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 26 mld lekë, duke u ulur me 16,5 %, krahasuar me Prill 2016 dhe me 15,4 %, në krahasim me Mars 2017.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e jashtme, Prill 2015 – Prill 2017 (%)




Në katër muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 87 mld lekë, duke u rritur me 16,4 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 183 mld lekë, duke u rritur me 4,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 96 mld lekë, duke u ulur me 5,3 %, krahasuar me 2016.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 13,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Prodhime druri dhe letre” me -0,3 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Prill 2017




Eksportet, gjatë katër muajve të parë janë rritur me 16,4 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +6,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +3,4 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, janë: “Prodhime druri dhe letre” me -0,2 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 4,3 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,5 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,4 pikë përqindje, “Ushqim,pije,duhan” me -0,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,7 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,3 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me +0,2 pikë përqindje.

Fig.3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Prill 2017



Importet, gjatë katër muajve të parë, janë rritur 4,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve janë: “Produkte kimike dhe plastike” me +1,7 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me 1,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,0 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar negativisht në ndryshimin vjetore të eksporteve janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,6 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Prill 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Prill 2016 janë: Italia me (1,3 %), Kosova me (8,3%) dhe Spanja me (126,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Serbia me (-21,6 %), Mali i Zi me (-3,4 %) dhe Zvicra me (-42,3 %).

Gjatë katër muajve të parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (9,6 %), Kosova me (22,7 %) dhe Spanja me (142,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Zvicra me (-35,9 %), Holanda me (-26,7 %) dhe Malta me (-96,3 %).

Në muajin Prill 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Prill 2016 janë: Italia me (3,8 %), Turqia me (2,9 %) dhe Kina me (4,6 %) dhe. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Greqia me (-1,9%), Gjermania me (-48,9 %) dhe Rusia me (-40,1 %).

Në katërmujorin e parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (2,6 %), Turqia me (9,2 %) dhe Greqia me (5.1). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-4,6 %), Kina me (-10,0 %) dhe Rusia me (-25,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Prill 2017



Shkëmbimet tregtare, për katër muajt e parë, me vendet e BE zënë 65,6 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Prill 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,5 %), Gjermania (7,3 %), Greqia (6.8) dhe Kina (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi Vjetor	Importe	Ndryshimi Vjetor	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-171	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-297	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-301	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2014	01 - 14	18	-1,4	35	2,2	-17	51,2
	02 - 14	20	27,9	39	17,5	-19	51,8
	03 - 14	21	10,4	42	11,1	-21	50,1
	04 - 14	23	10,3	44	6,8	-22	51,3
	Janar – Prill 2014	82	11,2	161	9,3	-79	51,1
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-20	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	Janar – Prill 2015	79	-3,7	162	0,8	-83	48,8
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	Janar – Prill 2016	74	-5,9	176	8,2	-101	42,4
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	15,2	-30	43,7
	04 - 17	24	13,6	50	-4,3	-26	48,2
	Janar – Prill 2017	87	16,4	183	4,1	-96	47,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Prill-16	Prill-17	Jan.- Prill.2016	Jan.- Prill. 2017	Prill-16	Prill-17	Jan.- Prill.2016	Jan.- Prill. 2017
Vendet e BE-së	15.452	17.317	58.574	66.399	34.595	31.771	107.241	110.288
Austri	93	197	408	491	513	516	1.721	1.605
Mbretëri e Bashkuar	3	22	112	93	395	396	1.249	1.586
Gjermani	674	1.011	2.648	3.646	8.055	4.119	16.810	16.042
Greqi	916	1.115	3.257	3.854	4.300	4.217	13.881	14.587
Itali	11.461	11.606	43.244	47.388	14.668	15.225	52.398	53.750
Spanjë	670	1.521	1.738	4.205	823	1.064	3.248	3.741
Kroaci	44	62	197	213	421	303	1.239	1.209
Të tjera të BE-së	1.590	1.782	6.970	6.510	5.419	5.932	16.695	17.768
Kinë	424	1.323	1.332	3.838	2.842	2.973	15.021	13.520
Kosovë	1.877	2.033	5.003	6.139	609	712	1.540	2.313
Maqedonia	677	780	1.659	2.408	718	742	2.090	2.435
Rusi	-	26	1	32	1.954	1.170	4.128	3.061
SHBA	146	175	474	880	645	675	2.773	2.938
Turqi	97	166	362	648	4.023	4.140	13.768	15.039
Ukrainë	10	31	46	202	704	230	1.361	1.080
Zvicër	553	319	940	603	396	502	2.778	2.844
Të tjera	1.901	1.834	6.076	5.495	5.493	6.850	24.936	29.353
Gjithsej	21.136	24.004	74.469	86.645	51.979	49.765	175.636	182.872

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Prill-16	Prill-17	Jan.- Prill.2016	Jan.- Prill. 2017	Prill-16	Prill-17	Jan.- Prill.2016	Jan.- Prill. 2017
Gjithsej	21.136	24.004	74.469	86.645	51.979	49.765	175.636	182.872
Ushqime, pije, duhan	2.172	2.607	6.880	7.453	8.877	8.826	30.850	31.818
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.226	4.949	12.208	16.894	3.245	4.105	15.237	16.525
Produkte kimike dhe plastike	385	480	1.381	1.438	7.462	7.245	24.767	27.686
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	205	231	976	867	1.681	1.802	5.080	5.374
Prodhime druri dhe letre	666	598	2.517	2.390	1.889	1.965	6.964	6.753
Tekstile dhe këpucë	8.841	9.385	35.053	37.606	7.036	7.051	24.472	26.200
Materiale ndërtimi dhe metale	3.162	3.750	9.719	13.480	10.394	7.016	25.467	22.708
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	878	1.357	3.555	4.382	9.719	9.861	37.019	38.766
Të tjera	602	646	2.180	2.136	1.675	1.895	5.781	7.043

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Prill. 2016, Jan.-Prill. 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	43.244	47.388	5.003	6.139	1.738	4.205	3.257	3.854
Ushqim, pije duhan	2.416	2.033	704	680	262	298	631	549
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	1.543	3.957	889	1.991	614	3.193	132	93
Produkte kimike dhe plastike	473	445	439	399	-	2	102	183
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	888	665	0	2	3	4	19	23
Prodhime druri dhe letre	1.908	1.743	95	111	2	2	272	280
Tekstile dhe këpucë	28.471	29.627	19	41	631	569	1.535	1.687
Materiale ndërtimi dhe metale	4.073	5.082	2.257	2.428	196	132	431	575
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	2.489	2.747	218	177	22	1	27	335
Të tjera	982	1.088	382	311	7	3	106	131

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Prill. 2016, Jan.-Prill. 2017)

(milionë lekë)

	Itali		Gjermani		Turqi		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjithsej	52.398	53.750	16.810	16.042	13.768	15.039	13.881	14.587
Ushqim, pije duhan	5.438	5.596	1.331	1.233	1.636	1.918	4.837	4.393
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5.683	5.348	183	189	203	535	915	1.792
Produkte kimike dhe plastike	4.950	5.831	1.940	2.392	1.993	2.197	2.459	2.595
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	4.057	4.191	1	2	98	104	36	21
Prodhime druri dhe letre	2.039	1.929	265	208	851	918	761	786
Tekstile dhe këpucë	12.636	13.155	800	740	4.608	4.803	1.199	1.183
Materiale ndërtimi dhe metale	5.404	5.828	4.816	2.641	1.701	1.602	2.212	2.495
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	10.559	10.040	7.115	8.118	2.093	2.284	953	748
Të tjera	1.632	1.832	358	519	586	679	508	574

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri